

Në bazë të nenit 50 paragrafi 9 të Ligjit për duhanin, produkte të duhanit dhe produkteve të përafërta (\*) („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.98/19 dhe 27/20), ministri i Ekonomisë në pajtim me ministrin e Shoqërisë Informatike dhe Administratës miratoi

**RREGULLORE PËR FORMËN DHE PËRMBAJTJEN E KËRKESËS PËR REGJISTRIM NË REGJISTRIN E EKSPORTUESVE DHE IMPORTUESVE TË PRODUKTEVE TË DUHANIT DHE PRODUKTEVE TË PËRAFËRTA, SI DHE DËSHMITË DHE DOKUMENTACIONIN E NEVOJSHËM**

Neni 1

Me këtë rregullore përcaktohen forma dhe përmbajtja e kërkesës për regjistrim në Regjistrin e eksportuesve dhe importuesve të produkteve të duhanit dhe produkteve të përafërta, si dhe dëshmitë dhe dokumentacioni i nevojshëm

Neni 2

Kërkesa për regjistrim në Regjistrin e eksportuesve dhe importuesve të produkteve të duhanit dhe produkteve të përafërta parashtrohet në formularin në A-4 format, në letër me ngjyrë të bardhë. Forma dhe përmbajtja e formularit të kërkesë nga paragrafi 1 i këtij neni, janë dhënë në Shtojcën, që është pjesë përbërëse e kësaj Rregulloreje.

Neni 3

Dëshmitë dhe dokumentacioni i nevojshëm për regjistrim në Regjistrin e eksportuesve dhe importuesve të produkteve të duhanit dhe produkteve të përafërta janë:

- Gjendja rrjedhëse nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut, me veprimtari parësore tregti me shumicë me produkte të duhanit ose prodhim të produkteve të duhanit;
- Dëshmi për pronësi ose marrëveshje për qira të hapësirës së magazinës, me pajisje përkatëse për magazinim;
- Formular M1/M2 për së paku një person të punësuar me arsim të lartë dhe së paku një vit përvojë pune në tregtinë me duhan dhe produkte të përafërta dhe
- Diplomë për arsim të mbaruar të lartë për personin nga alineja 3 e këtij neni.

Neni 4

Me ditën e hyrjes në fuqi të kësaj Rregulloreje pushon të vlejë Rregullorja për formën dhe përmbajtjen e formularit për parashtrimin e kërkesës për regjistrim në Regjistrin e prodhuesve, eksportuesve dhe importuesve të produkteve të duhanit (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr.31/07).

Neni 5

Kjo rregullore hyn në fuqi ditën e radhës nga dita e publikimit në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut“.

Ministër i Ekonomisë  
**Kreshnik Bekteshi** n.p.

Nr. 11-2218/9  
3 nëntor viti 2020  
Shkup

Ministër i Shoqërisë Informatike dhe Administratës  
**Jeton Shaqiri** n.p.

Nr. 08/3-3174/3  
25 shtator viti 2020  
Shkup

\_\_\_\_\_  
Numri arkivor dhe data

DREJTUAR MINISTRISË SË EKONOMISË  
- Sektori për bashkëpunim ndërkombëtar tregtar

**KËRKESË**  
**PËR REGJISTRIM NË REGJISTRIN E EKSPORTUESVE DHE IMPORTUESVE TË PRODUKTEVE TË**  
**DUHANIT DHE PRODUKTEVE TË PËRAFËRTA**

Nga \_\_\_\_\_  
\_\_\_\_\_  
(Emërtimi dhe selia e subjektit)

Kërkojmë që të na bëhet regjistrim në Regjistrin e eksportuesve dhe importuesve të produkteve të duhanit dhe produkteve të përafërta:

Shënoje llojin e produktit me

- |   |   |
|---|---|
| <input type="checkbox"/> Cigare   | <input type="checkbox"/> Duhan për nuhatje                                |
| <input type="checkbox"/> Cigarelosë   | <input type="checkbox"/> Duhan për përtypje                               |
| <input type="checkbox"/> Puro   | <input type="checkbox"/> Duhan i padjegshëm                               |
| <input type="checkbox"/> Duhan për llullë   | <input type="checkbox"/> Lëng për e-cigare                                |
| <input type="checkbox"/> Duhan për mbështjellje të pavarur të cigareve të duhanit | <input type="checkbox"/> Produkte bimore (prej bimëve) produkte për pirje |
| <input type="checkbox"/> Duhan për llullë me ujë (nargile)                        |   |

Telefon dhe person për kontakt

\_\_\_\_\_

Personi përgjegjës

\_\_\_\_\_  
(emri dhe mbiemri)